

FLORIN ANGHEL, PROFESSOR PH.D.

University "Ovidius" of Constanța, Romania
fl.anghel.ct@gmail.com

**ENVER HOXHA DHE SHQIPËRIA NË PROPAGANDËN
E GAZETAVE RUMUNE NË FILLIMET E KOMUNIZMIT
(1945-1948)****Abstrakt:**

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, veçanërisht pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, marrëdhëniet diplomatike midis dy shteteve u zhvilluan dhe u konsoliduan me shpejtësi brenda pak vjetëve. Megjithatë, agresioni italian ndaj Shqipërisë, në prill të vitit 1939 i dobësoi në mënyrë të dukshme lidhjet dypalëshe në nivel konsullor, ndërsa vijimi i Luftës së Dytë Botërore i ndërpreu ato de facto.

Vetëm në mars të vitit 1948 u rivendosën marrëdhëniet diplomatike në nivel legatë, dhe kjo ndodhi vetëm pas vendosjes së pushtetit komunist në Bukuresht. Megjithatë, marrëdhëniet dypalëshe mbetën periferike dhe të zbrazëta në përmbajtje. Enver Hoxha ushqente një ndjenjë mospëlqimi ndaj Mbretit Mihai, i cili ishte dekoruar nga Stalini me urdhrin sovjetik "Pobeda", si dhe ndaj komunistëve rumunë të udhëhequr nga Gheorghe Gheorghiu-Dej.

Marrëdhëniet rumuno-shqiptare pas Luftës së Dytë Botërore u bënë jo vetëm periferike, por edhe më pak koherente në vizione dhe strategji, duke lënë pas dore trashëgiminë e tyre historike me vlerë. Shqipëria ishte shteti i fundit komunist europian me të cilin Rumania rivendosi marrëdhëniet diplomatike në mars të vitit 1948, si dhe regjimi i fundit komunist në Europë me të cilin Rumania ngriti nivelin e përfaqësimit në atë të ambasadës në vitin 1950.

Në këtë artikull trajtohen disa aspekte të mënyrës se si propaganda komuniste rumune e paraqiste Shqipërinë, Enver Hoxhën dhe shqiptarët. Elementet themelore të këtij pasqyrimi gjenden në organin zyrtar të shtypit komunist rumun "Scântea", në fillimet e regjimit totalitar, gjatë gjysmës së dytë të viteve 1940.

Fjalë kyç:

Rumani, Shqipëri, propagandë rumune, komunizëm, Enver Hoxha, Gheorghe Gheorghiu-Dej.

Pas Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, marrëdhëniet diplomatike midis dy shteteve u zhvilluan dhe u forcuan me shpejtësi brenda pak vjetëve, pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore. Agresioni italian ndaj Shqipërisë në prill të vitit 1939 dobësoi lidhjet midis dy vendeve në nivel konsullor, ndërsa Lufta e Dytë Botërore i ndërpreu ato *de facto*. Në mars të vitit 1948, marrëdhëniet diplomatike u rivendosën në nivel legate, dhe kjo ndodhi vetëm pas vendosjes së pushtetit komunist në Bukuresht.¹ Megjithatë, marrëdhëniet dypalëshe mbetën periferike dhe të zbrazëta në përmbajtje. Enver Hoxha ndiente një mospëlqim të thellë ndaj Mbretit Mihai (1940-1947), si edhe ndaj komunistëve rumunë të udhëhequr nga Gheorghe Gheorghiu-Dej. Traktati i parë politik dhe diplomatik midis Rumanisë dhe Shqipërisë u nënshkrua më 11 maj 1994, gjatë një vizite zyrtare në Bukuresht të Presidentit Sali Berisha.² Për më tepër, duhet theksuar se pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, gjatë periudhës së regjimeve komuniste në të dyja vendet, nuk u regjistrua asnjë vizitë zyrtare në nivel kryetarësh shteti midis Bukureshtit dhe Tiranës.

Objekti i këtij artikulli shkencor është përpjekja për të sjellë në vëmendje dhe diskutim një sërë situatash dhe pengesash, të cilat në masë të madhe formësuan këto marrëdhënie ndërmjet momentit të ardhjes në pushtet të Enver Hoxhës dhe konsolidimit të plotë të kontrollit mbi vendin (1944-1945) dhe hyrjes së Rumanisë në strukturat e regjimit

¹ Vladimir Tismăneanu, *Stalinism for All Seasons. A Political History of Romanian Communism* (Berkeley: University of California Press, 2003).

² “Tratat de înțelegere, colaborare și bună vecinătate între România și Republica Albania”, București, May 11, 1994, *Monitorul Oficial*, no. 318, November 16, 1994, në <https://www.monitoruljuridic.ro/act/tratat-din-11-mai-1994-de-intelegere-colaborare-si-buna-vecinatate-intre-romania-si-republica-albania-emitent-parlamentul-publicat-n-34052.html> (shikuar më 07.09. 2022).

komunist të modelit sovjetik (fundvitet 1947-1948). Pjesa më e madhe e paraqitjeve propagandistike u publikua në gazetën zyrtare komuniste rumune “Scânteia” gjatë gjysmës së dytë të viteve 1940.

Periudha e artë që shtrihet midis Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe ardhjes së Wilhelm Wied-it në krye të frontit të vendit (1914),³ përfaqëson një prani të paprecedent të Rumanisë në Shqipëri. Megjithatë, gjatë dy dekadave ndërmjet Dy Luftërave Botërore, nuk u nënshkrua asnjë traktat politik dypalësh midis Rumanisë dhe Shqipërisë, si dhe nuk pati vizita zyrtare në nivele të larta. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia,⁴ të dyja shtetet nuk i ruajtën më marrëdhëniet dypalëshe. Gjesti bujar i Mbretit Zogu I ndaj Nicolae Iorga-s, të cilit i dhuroi një parcelë toke buzë detit në Sarandë,⁵ ku gjatë viteve 1938-1939 veprroi Instituti rumun i drejtuar nga Dumitru Berciu,⁶ përbën faqen e fundit të romanit të dashurisë rumuno-shqiptare.

Përmbysja e regjimit të Mbretit Karol II (1930-1940) më 6 shtator 1940 dhe aleanca e Rumanisë me fuqitë e Boshtit fashist ndryshuan politikën rumune si ndaj Mbretit Zog, ashtu edhe ndaj Shqipërisë. Më 9 prill 1941, Radio Bukureshti përuroi emisionin “Ora e Shqipërisë” (“*Ora Albaniei*”),⁷ i cili vijoi transmetimin deri në rënien e regjimit fashist në Itali (1943). “Ora e Shqipërisë” në Radio Bukureshti përbënte veprimtarinë më të rëndësishme propagandistike shqiptare në Rumani deri në shembjen e regjimeve komuniste. Gjatë vizitës së Mbretit Viktor Emanuel III të Italisë në Shqipëri, në maj të vitit 1941, në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë vetëm diplomatët e Gjermanisë, Bullgarisë dhe Rumanisë.⁸

³ Florin Anghel, “Influente românești în Albania printului Wilhelm de Wied, 7 martie-3 septembrie 1914”, *Revista Istorică*, 5-6 (1994): 487-94.

⁴ Alberto Basciani, *L'impero nei Balcani. L'occupazione italiana dell'Albania, 1939-1943* (Roma: Libreria Editrice Viella, 2022).

⁵ “Romania demands the return of properties in Saranda”, *Euronews Albania*, 17.04.2023, në <https://euronews.al/en/romania-demands-return-of-properties-in-saranda/> (shikuar më 09.05. 2024).

⁶ Bogdan Tănăsescu, “Institutul Român din Albania”, in Bogdan Tănăsescu, Emil Păunescu eds., “Dumitru Berciu și Institutul Român din Albania”, *Caietele Dumitru Berciu*, Giurgiu, I (2011).

⁷ “Ora albaneză, la radio București”, *Curentul*, April 10, 1941: 3. Programi u përurua nga dr. Petre Janura në një konferencë të titulluar “Lidhjet historike, politike dhe kulturore, një parathënie e unionit italo-shqiptar të 12 prillit 1939”.

⁸ “Regele Împărat a vizitat pentru prima oară Albania”, *Curentul*, 12 May 1941: 4.

Në shtypin rumun të censuruar dhe të kontrolluar të viteve 1941-1944 nuk vërehet ndonjë ndryshim në mënyrën e perceptimit të kritikave të bëra ndaj Mbretit Zog dhe regjimit të tij politik, krahasuar me qëndrimin e mbajtur më vonë ndaj sovranit shqiptar, gjatë viteve të para të regjimit komunist, që nisi në vitin 1944. Prandaj, pas datës 23 gusht 1944, propaganda zyrtare komuniste në Rumani e pati shumë më të lehtë, duke marrë parasysh faktin se më parë edhe regjimi i Antonescu-t kishte promovuar një imazh tepër të pafavorshëm ndaj shtetit shqiptar të drejtuar nga Mbreti Zog, deri në prill të vitit 1939.

Portretet e Shqipërisë në “Scântea”, gazetë e miratuar zyrtarisht nga regjimi komunist rumun (1946-1948)

Pas Luftës së Dytë Botërore, me emërimin e Enver Hoxhës si drejtuesi më i lartë i regjimit komunist në Tiranë, marrëdhëniet shqiptarorumune u bënë jo vetëm periferike, por edhe më pak koherente në aspektin e vizioneve dhe të strategjive, duke braktisur trashëgiminë historike me vlerë. Shqipëria ishte shteti i fundit komunist europian me të cilin Rumania rivendosi marrëdhënie diplomatike, në mars të vitit 1948, si edhe regjimi i fundit komunist në Europë me të cilin ajo ngriti nivelin e përfaqësimit diplomatik në atë të ambasadës, në vitin 1950.⁹

Marrëdhëniet relativisht të ftohta midis Bukureshtit dhe Tiranës ishin gjithashtu rezultat i vështrimit armiqësor të Enver Hoxhës ndaj Rumanisë dhe komunistëve rumunë, një aspekt që udhëheqësi shqiptar nuk u kujdes ta trajtonte në mënyrë të matur as në disa prej kujtimeve të tij.¹⁰ Gjendja jo e mirë e marrëdhënieve dypalëshe mes dy regjimeve të reja komuniste u përcaktua gjithashtu edhe nga niveli i përfaqësimit diplomatik. Duke iu referuar motivimit jo shumë të favorshëm për partnerin shqiptar, më 20 mars 1948 shtypi i Bukureshtit vuri në dukje shkurtimisht se, më 18 mars të po këtij viti, Enver Hoxha kishte pranuar letrat e akreditimit të paraqitura nga ministri i ri i Rumanisë, Teodor

⁹ Për një listë të përfaqësuesve diplomatikë të Shqipërisë në Bukuresht, që nga fillimi i marrëdhënieve dypalëshe, shih: Luan Topçiu, “Privire asupra relațiilor bilaterale dintre România și Albania”, në Zsuzsa Plainer ed., *Albanezii din România* (Cluj Napoca: Editura Institutului pentru Studiarea Minorităților Naționale, 2020), 144. Me specifikimin se Vasil Konomi, i dërguar i Jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiptotë, dorëzoi letrat e akreditimit në Bukuresht më 15 mars 1948, dhe jo në vitin 1949, siç paraqitet gabimisht në tekst.

¹⁰ Enver Hoxha, *The Khrushchevites. Memoirs* (Tirana: 8 Nëntori, 1980).

Rudenko, i shoqëruar nga Cristina Luca, e cila mbante në atë kohë detyrën e këshilltares së shtypit.¹¹ Deri në atë periudhë, Rudenko mbante detyrën e drejtuesit të misionit diplomatik të Rumanisë në Beograd, ndërkaq njoftimi për shtyp i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Bukuresht, përcillte në mënyrë të ashpër nivelin e ulët të përfaqësimit në Shqipëri:

"Në kuadrin e kursimeve, u vendos që në disa shtete më të vogla ose me të cilat nuk kemi marrëdhënie shumë të afërta, të mos emërohen ministra të plotfuqishëm. Në ato shtete do të përfaqësohemi nga ministri ynë që ndodhet në një shtet fqinj".¹²

Kolonisë [diaspora] shqiptare në Rumani, kryesisht e vendosur në Bukuresht dhe Konstancë, iu mohua nga regjimi rumun e drejta për të vizituar vendlindjen e tyre (ose për të ruajtur lidhjet me familjet në Shqipëri), ndërsa institucionet dhe pronat e komunitetit shqiptar u mbyllën dhe u morën nën kontrollin e shtetit pas vendosjes së regjimit komunist në Rumani. "Bashkimi i Popullit Shqiptar", organizatë shqiptare e themeluar në vitin 1948, me seli në Bukuresht, në sheshin "Mihail Kogălniceanu" nr. 7, funksionoi për një periudhë të shkurtër. "Bashkimi i Popullit Shqiptar" veproi deri në prill të vitit 1950, kur u transformua dhe mori emërtimin "Komiteti Demokratik Shqiptar", i cili funksionoi deri në vitin 1953. Pas shpërndarjes së tij, komiteti u detyrua të dorëzonte pronat e tij (e njëjta gjë ndodhi me të gjitha unionet dhe komitetet e komuniteteve të tjera etnike), ndërsa përfaqësia diplomatike në Bukuresht rekomandoi që shqiptarët me pasaporta të paraqisnin kërkesën e tyre për shtetësi rumune, bazuar në parimin e "mosdërhyrjes në punët e brendshme të një shteti tjetër".¹³

Informacioni i parë mbi Shqipërinë, i botuar në gazetën "Scănteia", daton aty nga mesi i janarit të vitit 1946 dhe përbëhet nga raportime të marra nga Radio Moska ose nga agjencia sovjetike e lajmeve TASS, kryesisht mbi shpalljen në Tiranë të Republikës Popullore të Shqipërisë, si dhe mbi fitoren në zgjedhjet e Asamblesë Kushtetuese të Frontit Demokratik (organizatë politike që ishte levë e Partisë Komuniste të

¹¹ *Adevărul*, March 20, 1948: 4.

¹² *Po aty*.

¹³ Gelcu Sefedin Maksutovici, "Albanezii din România. Scurtă istorie", në Plainer Zsusza ed., *Albanezii din România* (Cluj Napoca: Editura Institutului pentru Studierea Problemei Minorităților Naționale, 2020), 100.

Shqipërisë).¹⁴ Ky informacion kishte një ngarkesë të fortë ideologjike, ku udhëheqësit fitimtarë nga Tirana përshkruheshin në një situatë heroike. Ngjarja u përshkrua tërësisht sipas vizionit të Enver Hoxhës, i cili në kujtimet e tij politike e përshkruan atë si “një nga festimet më të mëdha që ka njohur vendi në historinë e tij. Për herë të parë, populli pati mundësinë të shprehej dhe të vendoste për fatin e tij”.¹⁵ Shqipëria nuk ishte e pranishme për një kohë të gjatë në faqen e parë të gazetës zyrtare të Partisë Komuniste Rumune (PKR); ajo shfaqej vetëm në faqen e fundit, brenda lajmeve shumë të shkurtra, të reduktuara në madhësi, në stilin e telegrameve. Tre regjentët e Bullgarisë, të emëruar midis gushtit 1943 dhe shtatorit 1944, të arrestuar dhe të ekzekutuar nga udhëheqësit e vendit, konsideroheshin “patriotë” në gazetën “Scân-teia”, ku madje publikohej një intervistë e gjatë me njërin prej tyre, Teodor Pavlov, i cili ishte një komunist ilegal.¹⁶ Në kontrast me këtë, regjentët e Shqipërisë, të cilët morën pushtetin pas largimit të trupave fashiste italiane në vitin 1943, u konsideruan thjesht si “tradhtarë”. Të paktën kështu rezulton nga një lajm shumë i shkurtër, i marrë nga Radio Sofia dhe i publikuar më 20 shkurt 1946, lidhur me dënimin dhe ekzekutimin e regjentëve Anton Harapi dhe Lef Nosi, si dhe të ish-Kryeministrit Maliq Bushati.¹⁷

Qasja periferike ndaj Shqipërisë nga pikëpamja e propagandës komuniste rumune, në periudhën midis krijimit të qeverisë Petru Groza (6 mars 1945) dhe abdikimit të Mbretit Mihai I (30 dhjetor 1947), por edhe pas kësaj periudhe, pasqyrore në mënyrë të saktë dhe koherente natyrën, përmbajtjen dhe, mbi të gjitha, nivelin e marrëdhënieve politike, diplomatike dhe ideologjike midis dy shteteve. Pas vitit 1945, Shqipëria nuk u bë kurrë objektiv kryesor i interesave të jashtëm rumunë, si për

¹⁴ “Albania s-a proclamat Republică”, *Scân-teia*, January 13, 1946: 4; “Deschiderea Adunării Constituante albaneze”, in *Scân-teia*, January 14, 1946: 4; “Victoria Frontului Democrat în alegerile din Albania”, *Scân-teia*, January 17, 1946; “Republica albaneză în sârbătoare”, *Scân-teia*, January 18, 1946; “Ce conține proiectul de constituție a republicei albaneze”, *Scân-teia*, January 30, 1946: 4.

¹⁵ Enver Hoxha, *Laying the foundation of the new Albania. Memoirs and historical notes* (Tirana: 8 Nëntori, 1984), 563.

¹⁶ Minea Stan, “În vizită la Regentul Todor Pavlov”, *Scân-teia*, June 13, 1946:1.

¹⁷ “Foștii Regenți și fostul prim ministru al Albaniei au fost executați”, *Scân-teia*, February 20, 1946: 4; Anton Harapi (1888-1946), prift katolik shqiptar; Lef Nosi (1877-1946); dhe Maliq Bushati (1880-1946, Kryeministër i Shqipërisë nga data 13 shkurt deri më 12 maj 1943) u ekzekutuan natën e 14-15 shkurtit 1946.

shkak të statusit të Rumanisë si një vend ish-aleat i Hitlerit – një shtet i mundur nga lufta, por edhe i izoluar – ashtu edhe për shkaqe që lidhen me okupimin dhe administrimin sovjetik të vendit. Pas viteve 1944-1945, objektivat themelorë të politikës së jashtme rumune ishin: rikthimi i Rumanisë në gjirin e komunitetit ndërkombëtar pas rënies së regjimit prohitlerian të Ion Antonescu-t (1944),¹⁸ rikthimi i saj institucional në një territor të humbur, si Transilvania, si edhe rivendosja e marrëdhënieve me disa ish-aleatë, si Franca dhe Britania e Madhe, të cilat ishin përparësitë kryesore. Në fjalimet zyrtare të Enver Hoxhës për marrëdhëniet e jashtme të vendit të tij, Rumania nuk përmendej kurrë; në mënyrë të ngjashme, interesi i Bukureshtit për Shqipërinë mbeti shumë i ulët, pjesërisht për shkak të mungesës së pavarësisë vendimmarrëse, por edhe për shkak të mungesës së dukshme të empatisë personale dhe ideologjike midis udhëheqësve komunistë në kryeqytetet e të dyja vendeve.

Zyrtari i parë shqiptar që vizitoi Rumaninë pas Luftës së Dytë Botërore ishte Hysni Kapo, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë (nga viti 1943 deri në vdekjen e tij, në vitin 1979), anëtar i Byrosë Politike (1946-1979) dhe zëvendësministër i Punëve të Jashtme. Ai ishte një nga besnikët dhe këshilltarët më të ngushtë të Enver Hoxhës. Vizita e tij në Bukuresht, në fund të muajit shkurt 1948, lidhej me përgatitjet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike dypalëshe.

Në një konferencë për shtyp, të mbajtur më 25 shkurt 1948, në selinë e Ministrisë së Informacionit në Bukuresht, zyrtari nga Tirana nuk fshehu prioritetet e politikës së jashtme shqiptare, të cilat ishin të ndikuara nga “linja e forcimit të lidhjeve të miqësisë me Bashkimin Sovjetik dhe me demokracitë e popujve fqinjë, të cilat, të udhëhequra nga Republika Federative Popullore e Jugosllavisë, ofrojnë mbështetje ekonomike të pakushtëzuar për Republikën e re të Shqipërisë”.¹⁹ Megjithatë, Kapo pranonte faktin se

“Shqipëria dëshiron të forcojë lidhjet e miqësisë edhe me Republikën Popullore të Rumanisë, dhe shpreson që, pasi këto dy

¹⁸ Dennis Deletant, *Hitler's Forgotten Ally. Ion Antonescu and his Regime. Romania, 1940-1944* (London: Palgrave MacMillan, 2006).

¹⁹ “Albania dorește să strângă legăturile de prietenie cu Republica Populără Romîna. Hysni Kapo, ministrul adjunct de Externe al Republicii Populare Albaneze, a făcut declarații ziariștilor români”, *Scânteia*, February 27, 1948: 3.

vende të shkëmbejnë përfaqësuesit diplomatikë, marrëdhëniet ekonomike dhe kulturore midis tyre do të intensifikohen”.²⁰

Më 15 mars 1948, në Zyrën e Presidiumit të Asamblesë së Madhe Kombëtare të Rumanisë u paraqit Vasil Konomi, i dërguari i parë i Jashtëzakonshëm dhe ministri fuqiptotë i Republikës Popullore të Shqipërisë në Bukuresht. Ai u prit nga C.I. Parhon-i, Petre Constantinescu-Iaşi, Mihail Sadoveanu dhe Ion Niculi, në prani të ministres së Punëve të Jashtme rumune, Ana Pauker.²¹

Midis viteve 1945 dhe 1947 nuk u shënua asnjë veprimtari tjetër zyrtare, përveç një prezantimi të regjimit komunist shqiptar në shtypin rumun. Kjo konferencë u mbajt nga Theodor (Teodor) Heba, *Chargé d’Affaires* (i Ngarkuari me Punë) i Shqipërisë në Sofje, në hollin e hotelit luksoz “Athenée Palace” në Bukuresht, më 21 shtator 1946. Ishte intervista e parë e një zyrtari shqiptar në shtypin rumun²² pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike zyrtare në mars të vitit 1948.

“Zoti Heba flet rrjedhshëm rumunisht”, shkroi me habi kronisti i gazetës komuniste të Bukureshtit. Ky fakt, së bashku me pozicionin e tij në zemër të pushtetit në Tiranë gjatë viteve të para pas ardhjes në pushtet të Enver Hoxhës, pa dyshim që luajti një rol të rëndësishëm në emërimin e tij si i pari përfaqësues diplomatik komunist i Shqipërisë në Bukuresht, në verën e vitit 1948.²³ Më 14 qershor 1948, ai u prit zyrtarisht sipas

²⁰ Po aty.

²¹ *Adevărul*, March 16, 1948: 4.

²² “Lupta şi drepturila poporului albanez înfăţişate presei române de d. Th. Hebbe, însărcinat cu afaceri al Albaniei la Sofia”, *Scânteia*, September 25, 1946: 3.

²³ Teodor Heba përfaqësonte një figurë qendrore të diplomacisë komuniste shqiptare në periudhën 1945-1950. Ai ishte raportues i Shqipërisë në OKB gjatë viteve 1946-1947, i cili iu bashkua Komisionit të caktuar nga Këshilli i Sigurimit për të hetuar incidentet në kufijtë e Greqisë me Shqipërinë dhe Bullgarinë (qeveria e Sofjes emëroi Dimitar Ganevin, një tjetër ministër i ardhshëm i Bullgarisë në Bukuresht). Në vitin 1947, Teodor Heba ishte *Chargé d’Affaires* i Shqipërisë në Bullgari, më pas, midis viteve 1948-1949, ishte përfaqësues i Jashtëzakonshëm dhe ministër fuqiptotë në Bukuresht. Duke qenë anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i zgjedhur në Kongresin e Parë të Partisë (1945), ai drejtoi Kuvendin Popullor në Tiranë gjatë viteve 1950-1951. Më vonë, deri në vitin 1959, Heba shërbeu si drejtor i Drejtorisë së Personelit të Partisë së Punës. Më 18 janar 1961, përmes një rezolute sekrete të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, ai u shkarkua nga detyra dhe u përjashtua nga partia për “aktivitet oportunist” dhe “nënshtrim” ndaj “presioneve të borgjezisë”. Në një seancë plenare, ai pranoi se “nuk kishte lexuar kurrë ‘Kursin e Shkurtër mbi Historinë e Partisë Komuniste’, një fakt që u konsiderua nga Enver

pozitës së tij diplomatike nga Ana Pauker në selinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme,²⁴ si dhe nga Petru Groza në Këshillin e Ministrave më 17 qershor 1948.²⁵ Më 16 qershor të po këtij viti, Teodor Heba, i shoqëruar nga Koli Shuke, sekretar i legatës shqiptare në Bukuresht, i dorëzoi zyrtarisht letrat e akreditimit kryetarit të Presidiumit të Asamblesë së Madhe Kombëtare, C.I. Parhon, në prani të nënkryetarëve të Asamblesë, Petre Constantinescu-Iași dhe Ion Niculi, si edhe të ministres së Punëve të Jashtme Ana Pauker.²⁶ Menjëherë pas akreditimit të tij, Heba vizitoi më 20 qershor 1948 qendrën e kolonisë shqiptare në Konstancë, në selinë e “Bashkimit (Unionit) të Popullit Shqiptar”, me qëllim që të njihej me ta dhe të prezantohej para drejtuesve të pushtetit vendor të zonës bregdetare rumune.²⁷ Me interes është fakti se Teodor Heba nuk mbajti asnjë ligjëratë në selinë qendrore të “Bashkimit”, në sheshin M. Kogălniceanu nr. 7, në qendër të Bukureshtit.

Disa javë më vonë, në faqen e parë të gazetës “Scânteia”, pas një kohe të gjatë, u publikua intervista e fundit e një zyrtari shqiptar në shtypin rumun. Teodor Heba foli për mbështetjen e BRSS-së në ndërtimin e socializmit në vendin e tij; ai përmendi “rolin mbizotërues” të Partisë Komuniste Shqiptare në zhvillimin e “Shqipërisë së re” dhe rikujtoi të kaluarën e afërt me tone ideologjike të ashpra dhe të errëta.

“Në fund të luftës, – deklaroi ministri i Shqipërisë në Bukuresht, – nuk kishte asnjë urë të padëmtuar në vendin tonë. Ekonomia shqiptare pësoi dëme mbi 7 miliardë franga ari. Edhe para luftës, Shqipëria ishte një vend i varfër, me një ekonomi që ruante karakteristika të forta feudale. Rreth 30 familje bejlerësh (pronarë

Hoxha dhe kolegët e tij si “turpërues dhe i papranueshëm, jo vetëm për një anëtar të K.Q. të PPSH-së, por edhe për një anëtar të zakonshëm partie”. Shih: “Rezoluta e Komitetit Qendror të Partisë së Punës mbi aktivitetin oportunist të Tuk Jakovës, Manol Konomit dhe Teodor Hebës, 18 janar 1960”, në:

<https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/CIA-RDP80T00246A052300220001-6.pdf> (shikuar më 30.04. 2024).

²⁴ *Scânteia*, June 17, 1948.

²⁵ *Ibid.* June 20, 1948:5.

²⁶ *Ibid.*, June 18, 1948: 3.

²⁷ “Vizita d. Theodor Heba ministrul Albaniei în orașul nostrum”, *Dobrogea nouă*, Constanta, June 25, 1948: 4.

të mëdhenj tokash) zotëronin të gjithë sipërfaqen e tokës së punueshme si dhe të gjithë pasurinë e vendit”.²⁸

Në të njëjtën kohë me praninë e Hebës në sheshin e Pallatit Mbretëror, shkrimtari i njohur Miron Radu Paraschivescu u dërgua në Tiranë si korrespondent i gazetës “Scânteia”. Paraschivescu ishte korrespondenti i parë dhe i fundit i shtypit rumun që qëndroi në Tiranë gjatë katër dekadave të komunizmit. Megjithatë, prania e tij, si një meteor, rezultoi e kotë. Edhe qëndrimi i tij nuk zgjati shumë: ai e kuptoi, ose iu tha, se udhëheqësi shqiptar, Enver Hoxha, jepte deklaratat për shtyp vetëm në përputhje të plotë me liderët jugosllavë, veçanërisht nga këndvështrimi – shumë i dukshëm në atë kohë – sipas të cilit Shqipëria do të përfshihej në federatën e Titos.²⁹ Kështu, më 28 qershor 1946, në Beograd, Miron Radu Paraschivescu regjistroi një deklaratë të ftohtë, të shkurtër dhe të përmbledhur të Enver Hoxhës mbi marrëdhëniet rumuno-shqiptare. Ishte një nga referencat jashtëzakonisht të rralla mbi lidhjet midis Bukureshtit dhe Tiranës gjatë periudhës komuniste.

“Shqipëria Demokratike, – deklaroi Enver Hoxha në Beograd, – është e vendosur për të patur marrëdhënie të ngushta miqësore me Rumaninë. Vetëm reaksioni fashist kishte penguar në të shkuarën, krijimin e marrëdhënieve të mira midis vendeve tona”.³⁰

Si vëzhgim, kjo ishte hera e parë që një informacion mbi Shqipërinë u shfaq në faqen e parë të gazetës “Scânteia”.

²⁸ “Cu sprijinul Uniunii Sovietice și sub conducerea Partidului Comunist Albanez, Poporul albanez își făurește o viață mai bună. Interview acordat ziarului “Scânteia” de Theodor Heba, ministrul Republicii Populare Albaneze la București”, *Scânteia*, August 27, 1948: 1.

²⁹ Mark Kramer, “Stalin, the Split with Yugoslavia, and Soviet-East European Efforts to Reassert Control, 1948-1953”, në Timothy Snyder, Ray Brandon (eds.), *Stalin and Europe: Imitation and Domination, 1928-1953* (Oxford: Oxford University Press, 2014), 295-316; Ethem Çeku, *Kosovo and Diplomacy since World War II. Yugoslavia, Albania and the path to Kosova Independence*, trans. John Nash (London and New York: I. B. Tauris, 2016), 15-35; Jeronim Perović, “The Tito-Stalin Split: A Reassessment in Light of New Evidence”, *Journal of Cold War Studies*, Vol. 9, No. 2 (Spring 2007): 42-57; Ivo Banac, Richard West, *Tito and the Rise and Fall of Yugoslavia* (London: Sinclair- Stevenson, 1996), 217-228; Shih gjithashtu: Ylber Marku, “Shifting Alliances. Albania in the Early Cold War”, *Journal of Cold War Studies*, Vol. 24, No. 3 (Summer 2022): 80-115, https://doi.org/10.1162/jcws_a_01074.

³⁰ “Relațiile româno- albaneze”, *Scânteia*, June 30, 1946: 1.

Vetëm në fund të verës së vitit 1946, më 30 gusht, gazeta “Scânteia” publikoi materialin e saj të parë mbi zhvillimet politike në Shqipëri, të shkruar nga Horia Liman-i.³¹ Për më tepër, ky ishte artikulli i parë në shtypin rumun që i referohej drejtpërdrejt kultit të personalitetit të Enver Hoxhës, një figurë e panjohur për publikun që lexonte në Bukuresht, madje edhe për publikun komunist.

“Heronjtë, – shkroi Horia Liman-i, – dolën papritmas nga mesi i masave të punëtorëve dhe fshatarëve, heronj modernë që do të bartin lavdinë e kombit të ‘shqiptarëve’ (shqiponjave), të cilët janë të gatshëm të derdhin gjakun e tyre në çdo moment, për të shijuar qoftë edhe për një çast aromën e lirisë. Duke udhëhequr, me shumë vendosmëri, për ta çliruar popullin e tij nga zinxhirët e skllavërisë, i papërkulur në luftën e pakompromis dhe me mjaft mençuri – pavarësisht se ishte vetëm 38 vjeç – *ENVER HODJA* [Enver Hoxha], u bë flamuri i palëkundur dhe i pamposhtur i luftës për liri në çdo çast dhe skaj të vendit”.³²

Më 21 qershor 1947, “Scânteia” shkruante me një ton entuziast për rendin e ri politik dhe ideologjik në Shqipëri. Një shembull i përpjekjeve të Gheorghe Barbu-së për të bindur opinionin publik ishte ky:

“Populli shqiptar është mbërthyer nga një impuls i madh për zhvillimin e vendit. Produktiviteti i punës në miniera po rritet vazhdimisht. Rrugë të reja dhe kanale vaditëse po shfaqen; ekiye vullnetare rinore, pa kursyer asgjë, po punojnë në shumë prej tyre. Moçalet po thahen; kështu, bujqësia po fiton toka të reja. Në këtë vend, që ishte mbajtur në errësi nga një regjim kolonial, janë ngritur qindra shkolla të reja fillore dhe të mesme. Në dhjetor të vitit 1946, u hap institucioni i parë pedagogjik në Tiranë, baza e universitetit të ardhshëm”.³³

Ndërsa stalinizmi po bëhej një realitet i pandryshueshëm në shtetet e okupuara nga Ushtria e Kuqe, por edhe në rastin e Shqipërisë, marrëdhëniet që vendimmarrësit në Bukuresht patën me shtetin më të vogël komunist të Europës, u shfaqën si të dorës së dytë, në një kategori më të ulët krahasuar me partnerët e tjerë të kontinentit europian apo ata aziatikë. Në një prej raportimeve të fundit të gazetës “Scânteia” mbi

³¹ Horia Liman, “Albania între Tsaldaris și O.N.U.”, *Scânteia*, August 30, 1946: 1-2.

³² Po aty.

³³ Po aty.

ngjarjet e veçanta lidhur me vendosjen e komunizmit në Tiranë, u shfaq qartë hezitimi i zyrtarëve rumunë dhe sovjetikë për të festuar fitoret e Enver Hoxhës, si dhe për t'i dhënë atij vendin e merituar. Artikulli mbante titullin domethënës “Çaj në legatën e Shqipërisë”, kushtuar festës kombëtare të shqiptarëve, dhe u botua në faqen e dytë të gazetës “Scânteia” të datës 30 nëntor 1950.³⁴ Një takim jo aq interesant, nëse kemi durimin të lexojmë listën zyrtare të pjesëmarrësve. Nuk bëhet fjalë vetëm për pjesëmarrjen e dobët të trupit diplomatik të akredituar në Bukuresht (Republika Popullore e Kinës, Çekoslovakia, Hungaria, Republika Demokratike Gjermane, Polonia dhe Bullgaria), edhe pse në këtë takim ishte i pranishëm ministri shqiptar i Financave, Abdyl Këllezi,³⁵ i cili ishte mikpritësi, por çështja kryesore kishte të bënte, mbi të gjitha, me nivelin hierarkik të pjesëmarrësve. Ana Pauker, ministre e Punëve të Jashtme e Rumanisë, erdhi në pritje e shoqëruar nga ekipi i saj i zëvendësve (Avram Bunaciu, Grigore Preoteasa dhe Ana Toma) ndërkohë që, përveç saj, vetëm Iosif Chișinevschi (nënkryetar i Këshillit të Ministrave) dhe Emil Bodnăraș-i (ministër i Forcave të Armatosura) mund të konsiderohen figura të një niveli të lartë përfaqësimi.³⁶

Megjithatë, më shumë se gjashtë muaj pas vdekjes së Stalinit, “Scânteia” botoi, me rastin e festës kombëtare të Shqipërisë (29 Nëntor 1953), një editorial të gjatë të shkruar nga ministri i Drejtësisë së Shqipërisë, Bilbil Klosi, në të cilin, ai i referohej ndërtimit të komunizmit dhe arritjeve të tij, besimit që populli i kishte dhënë udhëheqësit Enver Hoxha, si dhe luftës kundër imperializmit dhe rrymave të brendshme antikombëtare. Pa dyshim, funksionari shqiptar theksonte në opinionin e tij drejtuar lexuesve rumunë:

Faktori vendimtar i çlirimit të popullit tonë ishte fitorja e Bashkimit Sovjetik, e ushtrisë dhe e popullit sovjetik mbi fashizmin”.³⁷

³⁴ “Ceaiul dela Legația Albaniei”, *Scânteia*, November 30, 1950: 2.

³⁵ “Painful testimony. Why Enver Hoxha shot out father Abdyl Kellezi former deputy prime minister and why we can't find his bones”, in *Memorie.al*, në <https://memorie.al/en/painful-testimony-why-enver-hoxha-shot-out-father-abdyl-kellezi-former-deputy-prime-minister-and-why-we-cant-find-his-bones/> (shikuar më 17.12. 2024).

³⁶ Po aty.

³⁷ Bilbil Klosi, “Marile succese ale poporului albanez în făurirea vieții sale noi”, *Scânteia*, November 29, 1953: 3.

Teksti ishte miratuar nga i dërguari i Jashtëzakonshëm dhe ministri fuqiplotë, Mihal Lako, i cili mbërriti në Bukuresht në platformën e stacionit hekurudhor verior për të marrë detyrën e tij, vetëm pak ditë pas funeralit të Stalinit.

“Më 18 mars, – shkruante “Scânteia” në një shënim të mbajtur për këtë ngjarje, – me rastin e mbërritjes, Mihal Lako u prit nga shoku Grigore Preoteasa, zëvendësministër i Punëve të Jashtme, Dionisie Ionescu, drejtor i Drejtorisë së Protokollit në Ministrinë e Punëve të Jashtme, dhe Ionel Cristea, zëvendësdrejtor në të njëjtën ministri. Nga legata e Republikës Popullore të Shqipërisë (RPSH), ishin të pranishëm Skënder Kumbaro, i ngarkuar me Punë *ad-interim*, së bashku me anëtarët e tjerë të legatës”.³⁸

Enver Hoxha dhe marrëdhëniet e ftohta me botën komuniste europiane

Anëtarët më të varfra të Bllokut Komunist të Europës, Rumania dhe Shqipëria, arritën të nënshkruanin një marrëveshje tregtare më 26 nëntor 1954, e cila pasqyrore jo vetëm fuqinë e kufizuar ekonomike të secilës prej tyre, por edhe nivelin mesatar e të dobët të marrëdhënieve dypalëshe.

“Brenda kësaj marrëveshjeje, – raportonte gazeta zyrtare e Partisë së Punëtorëve të Rumanisë, – Republika Popullore e Rumanisë do të furnizojë Shqipërinë me produkte naftë, letër, xhama dhe shtresa bituminoze, ndërsa Republika Popullore e Shqipërisë do të furnizojë Rumaninë me xeherorë kromi, ullinj dhe agrume”.³⁹ Ky nivel shkëmbimi, i cili nuk ishte shumë përfaqësues, ndikoi në mënyrë të natyrshme edhe në marrëdhëniet politike, diplomatike dhe ideologjike.

Në vitin 1946, gjatë përgatitjeve për nënshkrimin e traktateve të paqes midis Aleatëve dhe shteteve të mundura, Bukureshti dhe Tirana nuk gjetën shumë hapësira për të bashkëpunuar, as në marrëdhëniet dypalëshe, as në arenën ndërkombëtare. Burimet ideologjike, mbështetja e Kremlinit, interesi personal i Stalinit dhe, mbi të gjitha, projekti

³⁸ “Sosirea la București a ministrului Republicii Populare Albania”, *Scânteia*, March 19, 1953: 3.

³⁹ “Semnarea acordului comercial pe 1955 cu Republica Populară Albania”, *Scânteia*, November 30, 1954: 2.

komunist i Federatës Ballkanike, i cili nuk u mor aspak parasysh në Bukuresht deri në vizitën zyrtare të Georgi (Gjergj) Dimitrovit në janar 1948, i ndanë të dyja shtetet.⁴⁰ Sipas Enver Hoxhës, vendosja e regjimit totalitar në Rumani po zhvillohej me një ngadalësi të irritueshme. Vetëm gjatë verës së vitit 1946, një gjykatë politike vendosi të dënonte me vdekje mareshalin Ion Antonescu, së bashku me tre bashkëpunëtorët e tij më të afërt; ndërsa në Shqipëri, ashtu si edhe në Bullgarinë fqinje, dënimet e ekzekutuara kishin eliminuar shumicën e elitave politike, intelektuale dhe ekonomike. Për më tepër, gjatë vjeshtës së vitit 1946 po përgatiteshin edhe zgjedhjet e para parlamentare të organizuara nga qeveria e Petru Grozës. Ndërkohë, Shqipëria jo vetëm që kishte ndryshuar strukturën e parlamentit, duke eliminuar opozitën dhe lirinë e zgjedhjes politike, por gjithashtu kishte shfuqizuar Monarkinë, kishte institucionalizuar një kushtetutë komuniste dhe kishte shpallur Republikën Popullore (në janar të vitit 1946). Por kjo nuk ishte e gjitha: Mbreti Mihai I vijonte të ishte kreu i shtetit rumun, i vetmi monark në vendet e Ballkanit të okupuar nga sovjetikët, i shoqëruar nga propaganda komuniste, përfshirë atë të Kremlinit, por që gëzonte një popullaritet të jashtëzakonshëm në opinionin publik.

Enver Hoxha, në kujtimet e tij të fundit, nuk e duronte mënyrën se si komunistët rumunë e trajtuan një çështje kaq radikale dhe serioze, siç ishte ajo e vendosjes së totalitarizmit. Në të njëjtën kohë, E. Hoxha e përbuzte hapur dhe personalisht Mbretin Mihai I të Rumanisë. Gjithçka nisi me dekorimin e mbretit me “Urdhrin e Fitores” (“Pobeda”), çmimi më i lartë sovjetik që u jepej udhëheqësve të huaj, i cili iu dha monarkut rumun për kontributin e tij personal në aktin e datës 23 gusht 1944. Përkundrazi, batalionet partizane të Enver Hoxhës, propaganda e mbështetur kryesisht nga Titoja për të formuar legjendën e udhëheqësit suprem të popullit shqiptar, si dhe muajt e gjatë të konflikteve mes E. Hoxhës dhe kundërshtarëve të tij, brenda vendit dhe në administratat e pushtimit, nuk e bindën Stalinin që t’i jepte atij më shumë se disa takime në Kremlin, dhe këto u zhvilluan vetëm deri në vitin 1947. Edhe në moshë të vjetër, Enver Hoxha nuk ia fali Mbretit Mihai dhe rumunëve dëmin ideologjik dhe personal të shkaktuar nga Stalini.

⁴⁰ Cosmin Popa, *Între tentația imperiului și alianța strategică. URSS și Europa Centrală și de Est (1941-1953)*, (Cluj Napoca: Centrul de Studii Transilvane, 2012).

“Mihai, – shkroi udhëheqësi komunist i Tiranës, në vitin 1982, tre vjet para vdekjes së tij, – ishte pikërisht si i ati, dhe shprehja popullore ‘si ati, si biri’ i shkon saktësisht. Ky mbret karnevalesh bëri atë që bëri, duke marrë çmimin më të rëndësishëm sovjetik gjatë Luftës së Dytë Botërore, ‘Urdhrin e Fitores’, i cili, atëherë, mes të huajve, iu dha vetëm Eisenhowerit dhe Titos. Çfarë kishin bërë rumunët për të merituar këtë nderim? Kishin okupuar Ukrainën, Odesën dhe qytete të tjera sovjetike, së bashku me hitlerianët. Dhe çfarë bënte Mihai në atë kohë? Ai po argëtohej në pallatet e tij. Ky ishte një oportunitizëm i papranueshëm nga ana e sovjetikëve. Nuk duhej që të mendonin kurrë t’i jepnin kësaj krijese të pavlerë as edhe më të voglën dekoratë, e lëre më Urdhrin e Fitores. E mori urdhrin sepse nuk donte të kundërshtonte sulmin e Ushtrisë së Kuqe? Çfarë bëri ai? Ai thjesht ngriti duart lart dhe u dorëzua, kjo është e gjitha ajo që bëri. Dhe për këtë u dekorua me Urdhrin e Fitores, sepse u dorëzua?”⁴¹

Hidhërimi shqiptar ishte aq i madh, sa E. Hoxha nuk ngurroi të përdorte, në një tekst zyrtar, fjalë të ashpra edhe për Nënë Mbretëreshë Elena, të shqiptuara edhe në prani të Gheorghe Gheorghiu-Dej. Sovrania u quajt “një e përdalë e vjetër që dinte të gjitha rregullat, se si të manovronte”,⁴² në një kontekst ku Enver Hoxha kujtonte me shumë detaje, orët kur u vendos abdikimi i Mbretit Mihai të Rumanisë, më 30 dhjetor 1947.

Nga fundi i jetës së tij, udhëheqësi i Tiranës zyrtare shpjegoi me hollësi dhe përkushtim arsye të tjera se përse nuk dëshironte marrëdhënie normale me Rumaninë komuniste, përtej xhelozisë së motivuar ndaj sovranit të Bukureshtit. Më e rëndësishmja prej tyre, lidhet me dyshimin se Gheorghe Gheorghiu-Dej, Ana Pauker-i dhe të tjerë, të cilët kishin pushtet të plotë në fillim të vitit 1948, nuk do të ishin aq të aftë për të menaxhuar vendosjen e totalitarizmit komunist në Rumani, me shpejtësi dhe pa rezerva. E. Hoxha, duke qenë i bindur se ishte një lloj prelati për pastërtinë e regjimit, dyshonte për një lloj “marrëveshjeje” të shkruar ose të pashkruar, të pakufizuar, midis drejtuesve komunistë rumunë dhe Mbretit Mihai I, për shfuqizimin e monarkisë dhe shpalljen e Republikës Popullore. Pra, si mund të lexohen ndryshe kujtimet e Enver Hoxhës për Bukureshtin, në verën e vitit 1948, kur ai ndodhej i ftuar në një rezidencë mbretërore (Pallati i Mbretëreshës së Greqisë, Elisabeta), ku gjeti

⁴¹ Enver Hoxha, *The Titoites. Historical Note* (Tirana: Naim Frashëri, 1982), 518.

⁴² Po aty, 519.

gjithashtu vëllime me autografe të anëtarëve të shtëpisë mbretërore dhe albume fotografike që i përkisnin Mbretit dhe hallave të tij, Princeshave Elisabeta dhe Ileana?⁴³

Megjithëse më 17 mars 1948, Enver Hoxha mori vendimin për rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Rumaninë, ai nuk u nxitua për të hapur përfaqësinë diplomatike të Shqipërisë në Bukuresht apo për të dërguar atje një përfaqësues fuqiplotë.⁴⁴ Ai parapëlqeu të verifikonte personalisht cilësinë e regjimit komunist rumun, dhe këtë e bëri në qershor të vitit 1948, gjatë një vizite *incognito*, e cila, sipas tij, në realitet, kishte lidhje me Kongresin e Partive Komuniste Europiane, që Kremlini vendosi ta zhvillonte në Rumani. Mungesa e besimit ndaj udhëheqësve rumunë ishte e dukshme dhe nuk linte hapësirë për dyshime:

“Në vendin tonë gjithçka ishte në rregull, pushteti popullor ishte vendosur dhe kishte themele kushtetuese, ndërsa në Rumani nuk ishte kështu. Rumanisë i duhej kohë për të likuiduar monarkinë dhe Mbretin Mihai; në Rumani marrëdhëniet kapitaliste vazhdonin ende të funksiononin, pasi ekzistonin ende përkrahës të organizatës fashiste Garda e Hekurt të Antonescu-t, të cilët ishin aktivë, dhe unë e pashë këtë gjatë qëndrimit tim në Bukuresht. Faktori vendimtar në çlirimin e Rumanisë dhe në likuidimin e këtyre mbetjeve të rrezikshme ishte ushtria sovjetike. Të tjerat janë gënjeshtër të treguara nga Gheorghiu-Dej”.⁴⁵

Imazhi që E. Hoxha kishte për Gheorghe Gheorghiu-Dej nuk ishte vetëm kritik, por edhe ironik:

⁴³ Po aty, 516.

⁴⁴ Enver Hoxha është shprehur vetë: Në verën e vitit 1948, “ne nuk kishim ende një ambasadë në Bukuresht dhe as rumunët nuk kishin një të tillë në Shqipëri. Formalitetet e hapjes nuk ishin përfunduar ende, dhe marrëdhëniet midis vendeve tona të demokracisë popullore në periudhën e parë pas Çlirimit nuk ishin plotësisht në përputhje me rregullat diplomatike, por ekzistonin mjaft lidhje jozyrtare”. Hoxha, *The Titoites*. 511. Gjatë po kësaj vere, gazeta e miratuar zyrtarisht e komunistëve rumunë botoi, brenda dy muajve, tri herë në faqen e parë një informacion që lidhej drejtpërdrejt me Shqipërinë: një ftesë transparente për miqësi. Shih: “Comitetul Central al Partidului Communist Albanez demască politica conducătorilor iugoslavi în vederea subjugării Albaniei”, *Scânteia*, 4 korrik 1948: 1; “Aniversarea Armatei Naționale a Albaniei”, *Scânteia*, July 11, 1948: 1; “Interviul cu Theodor Heba, ministrul Albaniei la București”, *Scânteia*, August 27, 1948: 1.

⁴⁵ Hoxha, *The Titoites*, 511.

“Ai ishte një njeri i shkurtër, me sy të zinj, me fytyrë dhe flokë të errët, i veshur shumë mirë, që të jepte përshtypjen e një personazhi të famshëm, siç themi ne në Gjirokastër për njerëzit e fuqishëm dhe energjikë, që flasin me krenari për veten, të kënaqur me gjithçka që thonë e bëjnë”.⁴⁶

Nuk është e qartë nëse ato ditë vere në Bukuresht – të parat dhe të fundit për Enver Hoxhën në Rumani – provokuan një reagim të ndikuar nga xhelozia, apo nëse bëhej fjalë për një kritikë institucionale dhe ideologjike ndaj udhëheqësve rumunë, mbi mënyrën se si shoqëria rumune kishte përqaftuar komunizmin, pa asnjë idealizëm, por edhe për jetën e përditshme, e cila ndonëse me burime të pakta, përpiquej të kopjonte modelin e jetesës së periudhës ndërmjet Dy Luftërave Botërore. Madje, edhe Bukureshti, i gjymtuar nga pushtimi sovjetik, me mungesa ushqimore, racionalizim të rreptë të mallrave të konsumit, me rrënim të moralit shoqëror dhe të marrëdhënieve njerëzore, kishte një dallim të jashtëzakonshëm me Tiranën, praktikisht të pakrahasueshëm. Fakti që Enver Hoxha e përmendte këtë diferencë të madhe në nivel jetese dhe qëndrimi, tregon se ajo ishte plotësisht e qartë për të. Udhëtimi i tij me makinë, në një mëngjes qershori, përgjatë Calea Victoriei, mund të ketë përcaktuar përfundimisht rolin dhe të ardhmen e marrëdhënieve komuniste rumuno-shqiptare.

“Vura re, – shkruante Hoxha, i cili i ndiqte me kujdes këto hollësi, – se rrugët ishin të pastra, me pemë dhe kopshte, pa rrënoja apo dëme lufte, me dyqane shumë mirë të furnizuara, me vitrina të mbushura me mallra. Teksa shikoja, mendja më shkoi në atdheun tim, të shkatërruar nga lufta. Duke parë dyqanet e Bukureshtit plot dhe me gjithçka, më erdhën ndër mend dyqanet bosh të qyteteve tona”.⁴⁷

Ndoshta Enver Hoxha nuk e harroi kurrë këtë imazh për pjesën tjetër të jetës së tij. Pas mbërritjes në Tiranë, ai nisi debate të gjera me bashkëpunëtorët e tij më të afërt dhe, me miratimin e Moskës, filloi të kërkonte ndihmë të menjëhershme ekonomike për furnizimin dhe financimin e një vendi tashmë të falimentuar. Hoxha nuk ia fali kurrë Rumanisë fyerjen, të cilën, gjatë gjithë jetës, e konsideroi si një poshtërim nga Mbreti Mihai i Rumanisë. Brenda monolitit të plotë dogmatik

⁴⁶ *Po aty*, 512.

⁴⁷ *Po aty*, 517.

stalinist, regjimi komunist i Tiranës tregoi publikisht se marrëdhëniet me Rumaninë ishin dytësore. Për shembull, me rastin e përvjetorit të parë të shtetëzimit të ekonomisë rumune (që u zhvillua në qershor të vitit 1948), në kryeqytetin e Shqipërisë u mbajt vetëm një mbledhje politike modeste më 12 qershor 1949. Ajo nuk u organizua nën kujdesin e Partisë së Punës të Shqipërisë, por të Frontit Demokratik, dhe jo nën drejtimin e zakonshëm të Enver Hoxhës, por vetëm të ministrit të Financave, Abdyl Këllezi, me pjesëmarrjen e sekretarëve të Komitetit Qendror të Partisë, Tuk Jakova dhe Bedri Spahiu.⁴⁸

Nga viti 1949 deri në vdekjen e Stalinit në vitin 1953, pavarësisht mendimit personal të Enver Hoxhës për Rumaninë dhe rumunët, regjimi i Tiranës nuk hezitoi të kërkonte mjete financiare dhe produkte ushqimore nga Bukureshti. Më 18 dhjetor 1950, ministri shqiptar i Financave, Abdyl Këllezi, i kërkoi ministrit rumun të Financave, Vasile Luca, tri kredi të reja me vlerë 20 milionë rubla sovjetike secila, të cilat do t'i shtoheshin kredisë së dhënë në vitin 1949, në shumën prej 41 milionë rublash. Kërkesa e tij u miratua nga Byroja Politike e Partisë së Punëtorëve të Rumanisë më 20 prill 1951.⁴⁹ Në fakt, nuk kishte shumë alternativa: ambasadori i Republikës Popullore të Rumanisë (RPR) në Tiranë, në kulmin e çmendurisë staliniste, nuk hezitoi t'i dërgonte një raport sekret Bukureshtit zyrtar më 10 korrik 1950, në të cilin shkruante se:

“Situata ekonomike e Shqipërisë është e tmerrshme. Racionet ushqimore janë reduktuar në mënyrë drastike dhe në shumë raste, ato nuk kanë mundur të sigurohen”.⁵⁰

Me qëllim menaxhimin më të mirë të transportit të mallrave dhe të atyre pak udhëtarëve që guxonin të udhëtonin nga Rumania drejt Shqipërisë, u vendos një linjë e drejtpërdrejtë detare që lidhte portin e Konstancës me atë të Durrësit.

Bashkëshortja e parë e një udhëheqësi të huaj komunist, e cila u lavdërua në gazetën zyrtare të Partisë Komuniste të Rumanisë, pas vendosjes së regjimit totalitar, ishte Nexhmije Hoxha. Një rrëfim revolucionar dogmatik shoqëronte fotografinë e bashkëshortes dhe

⁴⁸ “Conferința festivă de la Tirana cu prilejul împlinirii unui an dela naționalizarea efectuată în Republica Populară Română”, *Scânteia*, June 14, 1949: 6.

⁴⁹ Cezar Stanciu, *Devotați Kremlinului. Alinierea politicii externe românești la cea sovietică în anii 50* (Târgoviște: Editura Cetatea de Scaun, 2008), 64.

⁵⁰ *Po aty*.

shoqes së udhëheqësit të Shqipërisë komuniste në artikullin e gjatë të datës 17 janar 1948:

“Mjaft e njohur në mesin e grave shqiptare është Nexhmije Hoxha, udhëheqësja e lëvizjes demokratike të grave. Ajo ishte vetëm 16 vjeçe kur së bashku me shokët e saj të luftës – Nano Spiru, Nietu Kane, Bajo Cușle, Hoho Nuși dhe Enver Hoxha*, që më pas u bë bashkëshorti i saj, nisi luftën partizane dhe shpërndarjen e manifesteve antifashiste”.⁵¹

Një përsëritje e gjatë dogmatike për bashkëshorten e Enver Hoxhës dhe ky ishte artikulli i parë dhe i fundit në shtypin komunist rumun: jo vetëm për shkak se marrëdhëniet midis dy shteteve nuk përputheshin, por duket se më vonë as Nexhmije Hoxha nuk mund të konkurronte me shoqet komuniste nga Bukureshti, veçanërisht me Elena Ceaușescu-n [Çausheskun]. Vlerësimet e mëvonshme kanë treguar se lufta revolucionare dhe meritat e Nexhmije Hoxhës ishin mite të krijuara për të legjitimuar pushtetin dhe veprimet e saj. Një prej këtyre këndvështrimeve, madje sugjeron se ajo duhet të ketë mbetur agjente besnike e Jugosllavisë së Titos për dekada të tëra dhe se nuk mund të mos ishte në dijeni të vendimeve për hakmarrje të përgjakshme ndaj shokëve të saj të Tiranës.⁵² Megjithatë, disa dekada pas rrëzimit të komunizmit, ish-Zonja e Parë e Shqipërisë totalitare vazhdonte t’i siguronte ata që dëshironin ta dëgjonin se, ndërkohë që Enver Hoxha e udhëhoqi Shqipërinë, ajo kishte bërë shumë për vendin e saj, po aq sa Nënë Tereza për Indinë.⁵³

Edhe pse të parëndësishme, marrëdhëniet midis Rumanisë dhe Shqipërisë patën momente të detyrimeve të ndërsjella gjatë periudhës së Stalinit. Një ilustrim i këtij fakti është rrëfimi i ambasadorit rumun në kryeqytetin e BRSS-së, Simion Bughici, që ai bëri në fund të dhjetorit

* Shënim. Sipas radhës, emrat e pasqyruar në artikull mund të kenë qenë: Nako Spiru, Nesti Konomi, Vojo Kushi, Gogo Nushi dhe Enver Hoxha.

⁵¹ “Femeia albaneză, forță dinamică în clădirea patriei sale noi”, *Scânteia*, January 17, 1948: 4.

⁵² Fahri Balliu, *Sinistra Doamnă. Văduva dictatorului albanez Enver Hoxha*, foreword by Vladimir Tismăneanu, afterword by Ismail Kadare (București: Editura Humanitas, 2009).

⁵³ Edison Kurani, “Dictator Enver Hoxha’s widow: I did for Albania, what Mother Teresa did for India”, *Independent Balkan News Agency*, October 5, 2015, në www.balkan.eu.com/dictator-enver-hoxhas-widow-albania-mother-teresa-india/ (shikuar më 06.07.2023).

1950 për ministren e Punëve të Jashtme rumune, Ana Pauker, rreth një episodi të ndodhur gjatë një pritjeje miqësore në selinë e ambasadës. Duke festuar dyvjetorin e Republikës Rumune, gjatë së cilës u ngritën disa gota, ministri finlandez në Moskë e konsideroi të arsyeshme të ankohej te kolegu i tij shqiptar për mënyrën se si diplomatët perëndimorë të akredituar në Bukuresht nuk respektoheshin.

"Ministria rumune e Punëve të Jashtme, – shprehej diplomati finlandez për kolegun e tij shqiptar, – nuk respekton as rregullat elementare të protokollit; thjesht për të kontaktuar me zyrën e Protokollit, duhet të telefonosh për ditë të tëra".⁵⁴

Diplomati shqiptar nuk vonoi, por i tregoi mikpritësit rumun për këtë çështje, i cili më pas ia raportoi ministres së Punëve të Jashtme, Ana Pauker.

Përfundime

Megjithëse periferike në hartën e perandorisë komuniste europiane, Rumania dhe Shqipëria kishin në dispozicion mjaft mjete ideologjike, politike, ekonomike dhe institucionale për të rilindur një histori dypalëshe me tradita të shkëlqyera, arritje të rëndësishme dhe një kujtesë të gjatë të përbashkët. Gjatë periudhës pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, përpjekjet e drejtuesve komunistë në Bukuresht dhe në Tiranë u përqendruan më shumë në përmbushjen e kërkesave të Kremlinit dhe në fitimin e besimit të Stalinit për ruajtjen e pushtetit në vendet e tyre, sesa në ndërtimin e një marrëdhënieje të vërtetë partneriteti. Në fakt, duke përjashtuar rastin e veçantë të Republikës Demokratike Gjermane, marrëdhëniet politike, diplomatike dhe ideologjike midis Rumanisë dhe Shqipërisë deri në vdekjen e Stalinit ishin të paqëndrueshme, me pak besim reciprok dhe pothuajse pa iniciativa për zhvillimin dhe thellimin e tyre. Kujtesa e bashkëpunimit të gjatë prej shekujsh, veçanërisht e themelimit të Lëvizjes Kombëtare dhe e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë me ndihmën e rumunëve dhe të Rumanisë, u injorua. Në vend të saj, emocionet negative të Enver Hoxhës ndaj shumicës së udhëheqësve komunistë rumunë përcaktuan për dekada të tëra, marrëdhëniet midis Rumanisë dhe Shqipërisë, të cilat, në fakt, ishin të kufizuara dhe të parëndësishme.

⁵⁴ Ion Calafeteanu, *Scrisoni çatë tovarăša Ana* (București: Editura Univers Enciclopedic, 2005), 324.

Bibliografi:

- “Albania s-a proclamat Republică”, in *Scânteia*, year XVII, no. 425, January 13, 1946.
- ANGHEL, Florin. “Influențe românești în Albania prințului Wilhelm de Wied, 7 martie-3 septembrie 1914”. *Revista Istorică*, no. 5-6 (1994).
- “Aniversarea Armatei Naționale a Albaniei”. In *Scânteia*, year XVII, no. 1167, July 11, 1948.
- BALLIU, Fahri. *Sinistra Doamnă. Văduva dictatorului albanez Enver Hoxha*. Foreword by Vladimir Tismăneanu, afterword by Ismail Kadare. București: Editura Humanitas, 2009.
- BANAC, Ivo & West, Richard. *Tito and the Rise and Fall of Yugoslavia*. London: Sinclair-Stevenson, 1996.
- BARBU, Gh. “Albania, țara munților înalți trăiește o viață nouă”. In *Scânteia*, year XVI, no. 850, June 21, 1947.
- BASCIANI, Alberto. *L'impero nei Balcani. L'occupazione italiana dell'Albania, 1939-1943*. Roma: Libreria Editrice Viella, 2022.
- CALAFETEANU, Ion. *Scrisori către tovarășa Ana*. București: Editura Univers Enciclopedic, 2005.
- “Ce conține proiectul de constituție a republicei albaneze”. In *Scânteia*, year XVII, no. 438, January 30, 1946.
- “Ceaiul dela Legația Albaniei”, *Scânteia*, year XIX, no. 1902, November 30, 1950.
- ÇEKU, Ethem. *Kosovo and Diplomacy since World War II. Yugoslavia, Albania and the path to Kosovan Independence*. Trans. John Nash. London and New York: I. B. Tauris, 2016.
- “Comitetul Central al Partidului Comunist Albanez demască politica conducătorilor iugoslavi în vederea subjugării Albaniei”. In *Scânteia*, year XVII, no. 1161, July 4, 1948.
- “Conferința festivă de la Tirana cu prilejul împlinirii unui an dela naționalizarea efectuată în Republica Populară Română”. In *Scânteia*, year XVIII, no. 1451, June 14, 1949.
- “Cu sprijinul Uniunii Sovietice și sub conducerea Partidului Comunist Albanez, Poporul albanez își făurește o viață mai bună. Interview acordat ziarului „Scânteia” de Theodor Heba, ministrul Republicii

- Populare Albaneze la București”. In *Scânteia*, year XVII, no. 1208, August 27, 1948.
- DELETANT, Dennis. *Hitler's Forgotten Ally. Ion Antonescu and his Regime. Romania, 1940-1944*. London: Palgrave MacMillan, 2006.
- “Deschiderea Adunării Constituante albaneze”. In *Scânteia*, year XVII, no. 426, January 14, 1946.
- “Femeia albaneză, forță dinamică în clădirea patriei sale noi”. In *Scânteia*, year XVII, no. 1022, January 17, 1948.
- “Foștii Regenți și fostul prim ministru al Albaniei au fost executați”. In *Scânteia*, year XVI, no. 456, February 20, 1946.
- HOXHA, Enver. *The Khrushchevites. Memoirs*. Tirana: 8 Nëntori, 1980.
- HOXHA, Enver. *The Titoites. Historical Notes*. Tirana: Naim Frashëri, 1982.
- HOXHA, Enver. *Laying the foundation of the new Albania. Memoirs and historical notes*. Tirana: 8 Nëntori, 1984.
- “Interviul cu Theodor Heba, ministrul Albaniei la București”. In *Scânteia*, year XVII, no. 1208, August 27, 1948.
- KLOSI, Bilbil. “Marile succese ale poporului albanez în făurirea vieții sale noi”. *Scânteia*, year XXIII, no. 2832, November 29, 1953.
- KRAMER, Mark. “Stalin, the Split with Yugoslavia, and Soviet-East European Efforts to Reassert Control, 1948-1953”. In Timothy Snyder, Ray Brandon eds., *Stalin and Europe: Imitation and Domination, 1928-1953*. Oxford: Oxford University Press, 2014, pp.295-316.
- KURANI, Edison. “Dictator Enver Hoxha’s widow: I did for Albania, what Mother Teresa did for India”. *Independent Balkan News Agency*, October 5, 2015.
- LIMAN, Horia. “Albania între Tsaldaris și O.N.U.” In *Scânteia*, year XVI, no. 612, August 30, 1946.
- “Lupta și drepturile poporului albanez înfățișate presei române de d. Th. Hebbe, însărcinat cu afaceri al Albaniei la Sofia”. In *Scânteia*, year XVI, no. 634, September 25, 1946.
- MAKSUTOVICI, G. S. “Albanezii din România. Scurtă istorie”. In Plainer Zsusza ed., *Albanezii din România*. Cluj Napoca: Editura Institutului pentru Studierea Problemei Minorităților Naționale, 2020.
- MARKU, Ylber. “Shifting Alliances. Albania in the Early Cold War”. *Journal of Cold War Studies*, Vol. 24, No. 3 (Summer 2022), pp. 80–115, https://doi.org/10.1162/jews_a_01074.
- “Ora albaneză, la radio București”. *Curentul*, year XIV, no. 4725, April 10, 1941.

- “Painful testimony. Why Enver Hoxha shot out father Abdyl Kellezi former deputy prime minister and why we can't find his bones”. In *Memorie.al*, in <https://memorie.al/en/painful-testimony-why-enver-hoxha-shot-out-father-abdyl-kellezi-former-deputy-prime-minister-and-why-we-cant-find-his-bones/>.
- POPA, Cosmin. *Între tentația imperiului și alianța strategică. URSS și Europa Centrală și de Est (1941-1953)*. Cluj Napoca: Centrul de Studii Transilvane, 2012.
- PETROVIĆ, J. “The Tito-Stalin Split. A Reassessment in Light of New Evidence”. *Journal of Cold War Studies*, Vol.9, No.2 (Spring 2007), pp.42-57.
- “Regele Împărat a vizitat pentru prima oară Albania”. *Curentul*, an XIV, nr. 4755, 12 May 1941.
- “Relațiile româno- albaneze”. In *Scânteia*, year XVI, no. 561, June 30, 1946.
- “Republica albaneză în sărbătoare”. In *Scânteia*, year XVII, no. 429, January 18, 1946.
- “Resolution of the C.C. of Labor Party regarding the opportunistic activity of Tuk Jakova, Manol Konomi and Teodor Hebe”, January 18, 1960. In <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/CIA-RDP80T00246A052300220001-6.pdf>. (shikuar më 30 .04. 2024).
- “Semnarea acordului comercial pe 1955 cu Republica Populară Albania”. *Scânteia*, year XXIV, no. 3143, November 30, 1954.
- “Sosirea la București a ministrului Republicii Populare Albania”. *Scânteia*, year XXII, no. 2613, March 19, 1953.
- STAN, Minea. “În vizită la Regentul Todor Pavlov”. In *Scânteia*, year XVI, no. 547, June 13, 1946.
- STANCIU, Cezar. *Devotați Kremlinului. Alinierea politicii externe românești la cea sovietică în anii 50*. Târgoviște: Editura Cetatea de Scaun, 2008.
- TĂNĂSESCU, Bogdan. “Institutul Român din Albania”. In Bogdan Tănăsescu, Emil Păunescu, "Dumitru Berciu și Institutul Român din Albania". *Caietele Dumitru Berciu*, Giurgiu, vol. I, 2011.
- TISMĂNEANU, Vladimir. *Stalinism for All Seasons. A Political History of Romanian Communism*. Berkeley: University of California Press, 2003.
- TOPÇIU, Luan. “Privire asupra relațiilor bilaterale dintre România și Albania”. In Zsuzsa Plainer ed., *Albanezii din România*. Cluj

Napoca: Editura Institutului pentru Studierea Minorităților Naționale, 2020.

“Tratat de înțelegere, colaborare și bună vecinătate între România și Republica Albania”, București, May 11, 1994. In *Monitorul Oficial*, no. 318, November 16, 1994.

“Victoria Frontului Democrat în alegerile din Albania”. In *Scânteia*, year XVII, no. 428, January 17, 1946.

“Vizita d. Theodor Heba ministrul Albaniei în orașul nostru”. In *Dobrogea nouă*, Constanța, year I, no. 42, June 25, 1948.

FLORIN ANGHEL, PROFESSOR PH.D.

University “Ovidius” of Constanța, Romania

fl.anghel.ct@gmail.com

S u m m a r y

ENVER HOXHA AND ALBANIA IN ROMANIAN NEWSPAPERS PROPAGANDA AT
THE BEGINNINGS OF COMMUNISM
1945-1948

After Albania's independence was proclaimed in Romania, the diplomatic relations between the two states quickly developed and strengthened in the few years which followed the First World War. The Italian aggression towards Albania, in April 1939 consequently weakened the ties between the two countries at the consular level, and the Second World War *de facto* severed them.

It was not until March 1948 that diplomatic relations were restored at the legation level, and this occurred only after the communist power had been established in Bucharest. However, bilateral relations remained marginal and devoid of substance. Enver Hoxha felt a personal repulsion towards King Mihai, who had been decorated by Stalin with the "Pobeda" Soviet order, and also towards the Romanian communists led by Gheorghe Gheorghiu-Dej. The Romanian-Albanian relations after World War II became not only peripheral but also less consistent in terms of visions and strategies, abandoning the valuable historical heritage. Albania was the last European communist state with which Romania re-established diplomatic relations in March 1948, and the last European communist regime with which it raised its representation to the embassy level in 1950.

Some aspects of Romanian communist perceptions of Albania, Enver Hoxha, and the Albanians are explored in this article. The basics are inserted in the official Romanian communist paper “Scânteia” at the beginning of the totalitarian régime, in the second half of the 1940s.

Keywords: Romania, Albania, romanian propaganda, communism, Enver Hoxha, Gh. Gheorghiu-Dej.

